



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 01/201
Datë: 23.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Amendamentit të Marrëveshjes për Themelimin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("Marrëveshja") - Neni 1.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij Vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/201
Datë: 23.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 48 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat e Publikë, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni i Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese për pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jeton Qela, U. D. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, kryesues;
 - 1.2. Venera Çerkini, U. D. Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, anëtare;
 - 1.3. Bekim Hoxha, U. D. Kryeshef në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, anëtar;
 - 1.4. Haxhi Metaj, Ekspert i Jashtëm, anëtar; dhe
 - 1.5. Hyzri Bunajku, Udhëheqës i NjMBNj në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij Vendimi që t'i kryej detyrat dhe përgjegjësitë e tij në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik dhe Rregulloren Nr. 15/2023, për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

PËR 
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë